



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE GJIROKASTËR

NOTER LAURETA I. TARE  
ADRESA NR.1, ONHEZMI, NR.267,  
NR.1  
TEL: 682306283



# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 1329

Nr. koleksioni: 792

Sarande më 09/06/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023021830084819940



**KKONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI**  
**(Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO )**

Sot, më datë 09.06.2023, para meje Notere Laureta Tare, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Gjirokastrë, me zyrë në adresën lagjia nr.1, Rr Onhezmi nr. 267/1, u paraqiten personalisht:

**DHURUES:** Kristi SINANI, atësia Ismail, amësia Renata, shtetas Shqiptar, lindur në Delvinë dhe banues në SARANDË, me adresë Teki Haderi 04320143; Nd. 19; H. 1; Ap. 5; Sarandë; Sarandë, 9701; Sarandë, lindur më 31/12/1996, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032683416 dhe nr. personal J61231070U, *ne cilësimin e Ortakut te Shoqërisë "Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO" sh.p.k, zoterues i 1 kuote qe perben 45 % te kapitalit te shoqërisë me vlere 45.000 leke me NIPT(NUIS) Nr. L94214803P me seli ne Sarande, Rr "Gjergj Araniti". Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi".*

**PRANUESE E DHURIMIT:** Renata SINANI, atësia Sako, amësia Uvlo, shtetase Shqiptare, lindur në Delvinë dhe banuese në SARANDË, me adresë Teki Haderi 04320143; Nd. 19; H. 1; Ap. 5; Sarandë; Sarandë; 9701; Sarandë, lindur më 20/11/1971, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036901592 dhe nr. personal H16120075F. *Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituese e dhurimit"*

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

**Baza Ligjore**

Neni 761 e vijues të Kodit Civil

Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

**TE DHENA PARAPRAKE**

Dhuruesi Z. Kristi Sinani, është ortak i shoqërisë dhe zotërues i 1 Kuote, që përbën 45% të kapitalit me vlere 45.000 leke, të Shoqërisë " Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO " SHPK, person juridik shqiptar, regjistruar pranë QKB-se, me NIPT L94214803P me seli ne Vlore, Sarande, Rr Gjergj Araniti Sarande.

Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, të datës 08.06.2023, është miratuar transferimi nga Z. Kristi Sinani, njëkohësisht dhe Ortak i Shoqërisë " Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO "

shpk, nëpërmjet dhurimit te 1 kuote, qe përbën 45% te kapitalit te shoqërisë, nga Ortaku Z. Kristi Sinani, te Pranuesi i Dhurimit znj. Renata Sinani.

**OBJEKTI I KONTRATESI**

Ortaku i Shoqërisë "Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO" shpk, Z. Kristi Sinani, deklaroi se i dhuron 1 kuote, që përbën 45 % të kapitalit të Shoqërisë " Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO " sh.p.k, tek Pranueses se Dhurimit, nënës se tij Renata Sinani.

**KALIMI I PRONESISE**

Menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Dhurimi te 1 kuote që përbën 45 % të kapitalit të Shoqërisë " Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO " shpk, do të zotërohet nga ortaket:

Znj. Adriana Beqaj Ortake e 1 kuote qe përbën 55% te kapitalit te shoqërisë  
Znj. Renata Sinani Ortake e 1 kuote qe përbën 45% te kapitalit te shoqërisë.

**TË TJERA**

Dhuruesi deklaroi se shoqëria tregtare "Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO"shpk nuk ka detyrime ndaj të tretëve përfshirë dhe ndaj ortakëve si dhe ndaj organeve tatimore.

Dhuruesi deklaroi dhe garantoi se kjo kuote është e lire dhe pa asnjë barrë.





A2023021830084819940

Dhuruesi deklaron dhe garanton se Shoqëria "Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO" shpk nuk është pale dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje sigurorese, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë, nëse një gjë e tillë ekziston atëherë përgjegjësia është e dhuruesit.

Dhuruesi deklaron me vullnetin e tij se do të përgjigjet në mënyrë solidare dhe pa asnjë kufizim, për të gjitha detyrimet e shoqërisë "Albania Ionian Coast Olive Oil- AICOO" shpk që mund të dalin deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate;

Përgjegjësia e Pranueses se Dhurimit, për detyrimet e shoqërisë, fillon që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve përfshirë dhe institucionet shtetërore, që nga data e krijimit deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, janë përgjegjësi e palës dhuruese.

Për të gjitha konfliktet që mund të lindin nga zbatimi i këtij neni palët deklarojnë se do ta zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se nuk do të gjejnë zgjidhje do ti drejtohen gjykatës kompetente.

Kjo kontratë hyr në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Kesaj kontratë i bashkëngjiten : vendim nr. 2336 date 08.06.2023, i asamblese se ortakeve, pergjigje nga kerkimi D ne RBS me date 07.06.2023, ekstrat nga QKB me date 09.06.2023 dhe kopje te dokumenteve te identifikimit.

Kontrata redaktohet në tre kopje origjinale, në bazë të nenit 62 germa "II" te Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë" me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, i lexohet palëve me ze te larte dhe te qare, ata deklaruan se e kuptuan aktin dhe pranojnë përmbajtjen e tij, ndaj e nënshkruan atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin dhe nënshkrimin, në përputhje me kërkesat e nenit 102 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Takse pulle ne vleren 700 leke elikujuar ne kopjen e arkives noteriale.

**DHURUES**

Kristi Sinani

**PRANUESE E DHURIMIT**

Renata Sinani

**NOTERE**

